

Kosovë

KRU “Mitrovica” reagon pas sulmit ndaj ekipit në terren: “Ndaj punonjësve u përdor armë zjarri”



Sinjali.com

29 Korrik 2026 19:39



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Mitrovica” ka reaguuar pas incidentit të ndodhur gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga punonjësit e saj në terren, ku dyshohet se ndaj ekipit është përdorur armë zjarri.

Sipas njoftimit të kompanisë, incidenti ka ndodhur gjatë një aksioni për çkyçjen e një konsumatori i cili nuk kishte shlyer obligimet financiare ndaj ujësjiellësit.

KRU “Mitrovica” ka bërë të ditur se konsumatori kishte qenë i furnizuar rregullisht me ujë, por pavarësisht njoftimeve dhe mundësive për pagesë ose marrëveshje për shlyerjen e borxhit, detyrimet nuk ishin përmbushur.

“Gjatë ndërmarrjes së veprimeve për çkyçjen nga rrjeti, punonjësit tanë janë përballur me sjellje të dhunshme, ku, sipas informacioneve të deritanishme, ndaj tyre është përdorur armë zjarri”, thuhet në reagimin e kompanisë.

Nga KRU “Mitrovica” kanë bërë të ditur se, fatmirësisht, rasti ka përfunduar pa pasoja në njerëz.

Kompania ka dënuar çdo formë të dhunës dhe kërcënimit ndaj punonjësve gjatë kryerjes së detyrave të tyre, duke kërkuar nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria që rasti të trajtohet me seriozitet dhe të merren masat e nevojshme ligjore.

Në fund, KRU “Mitrovica” u ka bërë thirrje konsumatorëve që obligimet financiare t’i përmbushin me kohë dhe çdo paqartësi apo mosmarrëveshje ta zgjidhin përmes rrugëve institucionale.

“Dhuna ndaj punonjësve që kryejnë detyrën e tyre nuk mund dhe nuk do të tolerohet”, ka përfunduar reagimi i kompanisë.

**Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica"**
about a week ago

REAGIM PUBLIK

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A. shpreh shqetësimin e thellë lidhur me incidentin e rëndë të ndodhur gjatë realizimit të detyrave zyrtare nga punonjësit e saj në terren.

Konsumatori është furnizuar rregullisht me shërbimin e ujësjiellësit, por nuk i ka përmbushur obligimet financiare ndaj Kompanisë. Pavarësisht njoftimeve dhe paralajmërimeve të vazhdueshme, si dhe mundësisë së ofruar për pagesën apo arritjen e një marrëveshjeje për shlyerjen e borx... [See more](#)

84

10

6

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera